

## ATEIZMI: RREZIKU I TIJ I MADH

Më 7 Gusht 1961, disa kozmonautë rusë u kthyen shëndoshë e mirë në tokë, pasi kishin udhëtuar rreth e përqark planetit tonë. Një vit më vonë, njeri nga kozmonautët, majori Juri Titov, gjatë një interviste, tregoi mbresat e udhëtimit të tij. Ndërmjet të tjerave ai tha: «Disa thonë se Perëndia jeton atje [në hapësirë]. Unë, kur isha në hapësirë, pashë rreth e rrotull me shumë vëmendje, por nuk më zuri syri ndonjë gjë. Nuk pashë as engjëj dhe as zota...Unë nuk besoj në Perëndi. Unë i besoj njeriut, fuqisë së tij, mundësive të tij dhe arsyes së tij.» Shtypi komunist me shpejtësi i shfrytëzoi thëniet e tij, duke botuar menjëherë karikatura të shumta që tregonin kozmonautë duke kërkuar Perëndinë në hapësirë.

Ajo që tha Titovi nuk ishte diçka e re. Te Psalmeve 42:3, 10, ekzistenca, kujdesi dhe aftësia e Perëndisë vihen në dyshim me sarkazëm. Te 2 Kronikave 32:10–16, ne lexojmë se si Asirianët tallen me ekzistencën e Perëndisë dhe me arrogancë vënë në dyshim kujdesin e Tij për njerëzit që besojnë në Të, aftësitë e Tij, si edhe faktin që Ai kontrollon çdo gjë. Vëreni vargun 15: «Prandaj tani mos e lini Ezekian t’ju gënjejë dhe t’ju mashtrojë në këtë mënyrë; mos i zini besë! Duke qenë se asnjë perëndi e ndonjë kombi apo mbretërie, nuk ka mundur të çlirojë popullin e vet nga dora ime apo nga dora e etërve të mi, aq më pak Perëndia juaj do të mund t’ju çlirojë nga dora ime!» Me shumë lehtësi ne mund të gjejmë shembuj të tjerë si këta, qoftë edhe nga jeta

jonë e përditshme, shembuj që flasin për njerëz që në krenarinë e tyre dalin haptas kundër Perëndisë. Idetë e ateistëve kanë qenë të pranishme midis njerëzve gjatë gjithë historisë. Dikur ato nuk pranoheshin nga shumica e njerëzve, ndërsa sot ato janë bërë standarti «i arsyetimit» të «intelektualëve» modernë!

Ateizmi përfaqëson një rrezik të madh në ditët e sotme. Fëmijëve sot u mësohet në mënyrë të përditshme se Perëndia nuk ekziston. Si shembuj të influencës së madhe së ateizmit ne mund të përmendim shkollat dhe televizionin. Shumë njerëz nuk i kushtojnë rëndësi kësaj përhapjeje të ateizmit. Ne duhet t’i kushtojmë vëmendje ateizmit dhe të kuptojmë rrezikun që ai mbart për njeriun (Psalmeve 33:12; Fjalët e Urta 14:34). Çfarë mund të thuhet për ateizmin? A ekziston Perëndia në të vërtetë apo është vetëm një krijesë e «nevojave psikologjike» të njeriut?

### SI U RRRIT INFLUENCA E ATEIZMIT

Ateizmi gjithnjë ka pasur zëdhënësit e tij. Gjatë gjithë këtyre viteve Satani në mënyrë të efektshme ka përdorur njerëz dhe grupe të caktuara njerëzish për përhapjen e filozofisë ateiste. Po të studiojmë historinë do të kuptojmë se si Satani ka manipuluar forcat e së keqes për të arritur qëllimin e tij, rrënjosjen e ateizmit në mendjet dhe zemrat e njerëzve. Shikoni disa nga mënyrat dhe mjetet që ai ka përdorur.

E para, Galilei, një matematikan, fizikan dhe

astronom i shekullit të gjashtëmbëdhjetë, kontribuoi në mënyrë indirekte në zhvillimin e ateizmit. Ai ishte i pari që guxoi të shpallte se toka nuk ishte qendra e sistemit diellor, por thjesht një pjesë e tij. Një zbulim i tillë, pa të drejtë, u konsiderua nga shumë njerëz si një blasfemi<sup>1</sup>, që vinte në dyshim faktin që Perëndia ishte krijuesi i gjithësisë. Ky zbulim nuk mund të provonte asgjë tjetër, veçse faktin se njohuria e njerëzve dhe e shkencës është gjithmonë e kufizuar. Por, nga ana tjetër, disa njerëz të tjerë filluan ta përdornin teorinë e tij për të justifikuar idenë e një universi që vepronte spontanisht. Dhe si rrjedhim këta njerëz shpallnin se ky univers nuk u krijua nga Perëndia. Zbulimi i Galileut i gëzoi ata, sepse tani ata pretendonin se kishin në dorë fakte «shkencore» për të justifikuar mohimin e ekzistencës së Perëndisë.

E dyta, Çarls Darwin zë një vend të rëndësishëm në zhvillimin e Filozofisë Ateiste. Teoria e tij për origjinën e njeriut tundi themelet e besimit të shumë kristianë. Hipoteza e Darvinit ishte vetëm një hap i mëtejshëm logjik i teorisë së gabuar se bota funksionon spontanisht. Në qoftë se universi nuk drejtohet nga Perëndia, por vihet në lëvizje spontanisht, atëherë pse nuk mund të funksionojë edhe njeriu në të njëjtën mënyrë si universi? Kështu u krijuan «bazat» me ndihmën e të cilave «mund» të argumentohet funksionimi spontan i njeriut. Burri dhe gruaja konsideroheshin prej tyre si qenie që kishin përfunduar në tokë rastësisht. Ata «ishin» thjesht rezultat i koincidencave në zhvillimin e specieve. Jobesimtarët e mohuan Perëndinë dhe besuan se nuk kishte ndonjë provë për të vërtetuar origjinën e njeriut nga Perëndia.

Kështu, ateizmi përdori «rezultatet e shkencës» për të «provuar» se Perëndia nuk ekziston. Ateizmi kishte «vërtetuar» se Perëndia nuk ekziston duke shtrembëruar teorinë e Galileut dhe duke pranuar teorinë e evolucionit si të vërtetë.

Personazhi i tretë ishte Karl Marksi. Ai ishte një armik i betuar i fesë. Qëllimi më i madh i jetës së tij ishte shkatërrimi i influencës së fesë. Ai e pa teorinë e Darvinit si një mjet që mund të përdorej për të eliminuar fenë dhe për të vendosur shoqërinë e «klasave».

Së katërti, filozofia ateiste ka influencuar edhe psikologjinë si shkencë. Zigmund Frojd përdori një akuzë të gënjeshtërt rreth fesë si bazë për krijimin e teorieve që do të shkatërrojnë edhe më tej besue-

shmërinë e saj. Frojdi e konsideroi fenë si faktore për gjithçka të keqe. Ai mendonte se gjithë veprimet e pakontrolluara ishin rezultat i moralit shtypës të fesë. Frojdi e shikonte moralin si një pengesë të rrezikshme që dëmtonte anën e vërtetë të njeriut. Ai e cilësoi besimin në Perëndi si «të ardhmen e një iluzioni» dhe kjo frazë shërbeu si titull për një nga librat e tij. Studimet e fundit kanë nxjerrë në pah pavlefshmërinë dhe të këqijat e ideve të Frojdit. Frojdi mbolli atë farë për të cilën kishte nevojë ateizmi. Psikologët ndjekës të Frojdit propaganduan idetë ateiste të tij. «Hierarkia e nevojave» sugjeron se njeriu përbrenda vetes ka aftësinë «për të bërë çdo gjë». Në këtë mënyrë, një tjetër psikolog, Maslov, e përjashtoi nevojën që ka njeriu për Perëndinë. Shkrimet dhe teoritë e B.F. Skinner akoma më tej e «largojnë» Perëndinë nga njeriu dhe e vendosin njeriun në të njëjtin nivel me kafshët.

Gjatë gjithë kësaj kohe, psikologjia arriti në përfundimin se njeriu është viktimë e mjedisit ku jeton. Në këtë mënyrë, psikologët u përpoqën t'i hiqnin njeriut çdo përgjegjësi për veprimet e tij. Çdo njeri, sipas tyre, mund të bëjë çdo gjë që dëshiron (të vrasë, të vjedhë, të gënjejë, të mashtrojë) pa mbajtur asnjë lloj përgjegjësie për veprimet e tij. Në fund të fundit, kush e ka fajin në qoftë se të gjithë të njerëzit janë «produkte të mjedisit»? Edhe ky «zbulim i psikologjisë» pati efektet e tij. Perëndia u fshi nga zemrat dhe mendjet e shumë njerëzve dhe njeriu u bë i papërgjegjshëm për veprimet e tij. Dhe, si rrjedhim, «shoqërisë» iu vu faji dhe u duk se e vetmja mënyrë për të korrigjuar problemet ishte përcaktimi nga udhëheqja politike i standarteve të së «drejtës» dhe të «gabuarës». Të pendohesh për gabimet e bëra dhe të korrigjohesh (metodë që vjen nga besimi në Perëndi) ishte diçka që përqeshej. Ideja se çdo njeri ishte personalisht përgjegjës për veprimet e tij konsiderohej budallallëk. Kështu, faji i hiqej njeriut dhe i hidhej shoqërisë. Perëndia u braktis me justifikimin se ishte një mit i dalë nga moda. Këto ndikime të psikologëve ekstremistë vazhdojnë madje edhe në ditët tona. Ato janë përfshirë në mendimet e shumë njerëzve dhe, ç'është më e keqja, shumë njerëz i konsiderojnë konkluzionet e këtyre filozofëve si të vërteta. Kështu, Satani në mënyrë të suksesshme ka bërë që shumë njerëz të mos e pranojnë se Perëndia ka të drejtë të udhëheqë jetët e tyre.

E pesta, disa filozofë kanë kontribuar në

fuqizimin e ateizmit. Midis shumë filozofëve, njëri ka patur një influencë të pallogaritshme. Ky është Frederik Niçe. Ai ishte një filozof gjerman që jetoi në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë dhe në fillim të shekullit të njëzetë. Shkrimet e tij lexoheshin dhe respektoheshin nga një masë e gjerë njerëzish. Hitleri, Musolini dhe Stalini u influencuan nga idetë e Niçes. Shumë shkrimtarë ranë nën influencën e tij. Ishte filozofia e Niçes që udhëhoqi lëvizjen me moton «Perëndia ka vdekur!» në shekullin e njëzetë. Teoritë e Niçes influencuan njerëzit që «përruljen» (ndaj çdo lloj forme autoriteti) ta konsideronin të gabuar. Ai pretendonte se «e mira» dhe «e keqja» janë relative. Kjo do të thotë se, nëse unë mendoj se të vjedhësh është mirë, kjo, sipas teorisë së Niçes është e drejtë dhe është punë për mua nëse unë mendoj në këtë mënyrë. Nga ana tjetër, nëse ju mendoni se të vjedhësh është e gabuar, kjo sipas teorisë së Niçes, është e drejtë gjithashtu. Kështu ne nuk mund të themi me siguri nëse të vjedhësh është mirë apo keq në parim. Sipas Niçes vetëm budallenjtë dhe injorantët do të mendonin ndryshe. Sidoqoftë, Niçe ishte i vetëdijshëm për pasojat e filozofisë së tij. Ai e shikonte jetën e njerëzve në tokë pa praninë e Perëndisë dhe gjente aty vetëm një pamje të trishtuar. Ndjekësit e tij janë të bindur se jetojnë në një botë që funksionon aksidentalisht. Ata besojnë se nuk ka Perëndi që mund t'i drejtojë njerëzit. Sipas tyre në fund të jetës së njeriut ka vetëm errësirë dhe asnjë lloj shprese. Sipas filozofisë së Niçes, planeti ynë është në një gjendje të mjerueshme dhe të pashpresë!

Fakti që Niçe vetë e kuptonte se si është bota dhe njerëzimi pa praninë e Perëndisë është për t'u admiruar. Ai pa një botë që e kishte «vvarë» Perëndinë. Ai sugjeroi se meqenëse Perëndia ishte «hequr qafe», shekulli i njëzetë do të shquhej për dy gjëra të tmerrshme: (1) Ai do të ishte shekulli më i përgjakur në historinë e njerëzimit dhe (2) do të ishte shekulli i çmendurisë universale. Mund të shikosh vetëm lajmet e përditshme në gazeta dhe televizor për të kuptuar se Niçe kishte të drejtë. Njeriu pa Perëndinë provon vetëm tragjedi!

Këta faktorë u përputhën mirë me qëllimin e Satanit dhe kontribuan për të sjellë krizën e ditëve të sotme. Shoqëria e sotme po vuan pasojat e hidhura të këtyre dukurive: (1) Niçja i konsideroi Lumturitë (që gjenden në kapitullin e pestë të Mateut) si mësim të këqija për jetën e njeriut. Për te, ato

vetëm sa i thurnin lavde dobësisë njerëzore. Një shoqëri që udhëhiqej nga Lumturitë do të ishte një shoqëri e të «humburve». Si rrjedhim, ai inkurajoi «të fortin» që të ecte përpara, të dominonte dhe të shtypte të tjerët. (2) Ligji moral u braktis. Në qoftë se universi dhe njeriu janë produkte të shkaqeve natyrore, në qoftë se nuk ka ndonjë Perëndi që të drejtojë, atëherë është absurde që të mendojmë për të mirën dhe të keqen absolute. Shoqëria jonë moderne gjendet jashtë kontrollit. Morali absolut mohohet dhe zëvendësohet me moralin relativ (që do të thotë: çfarë unë mendoj se është e mirë mund të jetë e keqe në gjykimin tënd, por megjithatë ne të dy kemi të drejtë!). Të rinjtë tanë rriten në një shoqëri që nuk e respekton ligjin dhe ku asnjëri nuk bën as më të voglën përpjekje për t' i edukuar ata moralisht! (3) Në qoftë se njeriu është produkt i evolucionit të specieve (sipas teorisë së Darvinit), atëherë ai nuk është i përgjegjshëm madje as edhe për krimet më të tmerrshme.

## **PARAQITJA E PAVLEFSHMËRISË SË ATEIZMIT**

Një ide e thjeshtë mjafton për të provuar falsitetin e teorisë së ateizmit. Të gjitha teoritë e gabuara shquhen për karakterin kontradiktor të tyre. Ateizmi është një teori e mbushur me kontradikta gjithashtu. Megjithatë ata që mbrojnë idetë e tij nuk janë në gjendje t'i shikojnë këto fakte.

Mësimet në kapitujt e tjerë do të përqëndrohen në këtë boshllëk të ateizmit. Secili mësim do të ekspozojë një aspekt të Filozofisë Ateiste dhe do të demonstrojë paqëndrueshmërinë dhe gabimet e saj. Në të njëjtën kohë do të shikojmë se të besosh te Perëndia jo vetëm që është e drejtë, por gjithashtu është e vetmja rrugë nëpërmjet së cilës mund të shpjegojmë botën që na rrethon. Besimi në Perëndi na ndihmon të kuptojmë se si erdhi njeriu në këtë tokë, çfarë bën këtu dhe cili është destinacioni i tij.

Ateizmi, në qoftë se kuptohet, është një filozofi jo shumë serioze dhe e mbushur me kontradikta. Sfida e ateizmit dhe efekti i tij midis nesh zvogëlohen, nëse ndërjegjësohemi për gabimet e tij të dukshme.

## **KONKLUZIONI**

Shumë njerëzve në SHBA akoma mund të kujtojnë ngjarjet e Ditës së Krishtlindjeve të vitit

1968. Atë ditë tre astronautë të tjerë do të jepnin mendimin e tyre rreth Hyjnisë. Këta tre amerikanë ishin njerëzit e parë që udhëtonin përreth anës «së errët» të hënës. Ata udhëtuan me raketën «Apollo 8». Ata e panë tokën nga një pozicion që asnjë njeri tjetër nuk e kishte parë më parë. Fotografia që fikson atë pamje emocionuese është parë nga shumë njerëz që nga ajo kohë. Astronautët e «Apollo 8» panë tokën të ngrihej mbi horizontin e hënës, e «veshur» me një kombinim të bukur të ngjyrës blu dhe të bardhë. Në atë moment të caktuar toka dukej e rrethuar nga shkëlqimi i zjarrtë i diellit në kontrast me hapësirën e errët përreth saj. Në këtë moment mrekullues, fjalët e para që u dëgjuan nga ekuipazhi i anijes kozmike «Apollo 8», që ndodhej atje ku asnjë njeri tjetër nuk kishte shkuar më parë, ishin: «Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën...» (Këto janë fjalët me të cilat hapet Bibla, Zanafilla, kapitulli i parë.) Përfundimi i tyre ishte krejt i ndryshëm nga ai i Titovit!

Çfarë duhet të bëjë njeriu i sotëm përballë sfidës së ateizmit? Le të ndjekim shembullin e Mbretit Hezekia. Kur armiqtë e tij, Asirianët, erdhën poshtë mureve të Jeruzalemit për ta pushtuar atë, i bënë thirrje atij dhe popullit të tij që të dorëzohej. Ata përmendën faktin se ushtria e tyre ishte shumë më e madhe dhe më e fuqishme se ushtria e Hezekias. Asirianët bile u tallën me mbretin Hezekia për besimin e tij se Perëndia do ta ndihmonte atë kundër ushtrisë së pathyeshme asiriane. Por Hezekia besoi te Perëndia i Plotfuqishëm për fitoren (2 Mbretërve 19:14). Besimi i tij nuk u dobësua. Vendosmëria e tij nuk u lëkund. Hezekia e përballoi situatën me siguri, sepse ai e dinte se Perëndia do të dilte fitimtar (2 Mbretërve 19:22, 28, 34–35; 2 Kronikave 32:21b).

### SHËNIME

<sup>1</sup> Mungesa e shfaqjes së nderimit të duhur ndaj Perëndisë: të flasësh kundër Perëndisë dhe të veprosh sikur Ai të mos ekzistonte është blasfemi.

Autor: *John L. Kachelman, Jr.*  
Marrë nga studimi: “*Perëndia kundër ateizmit*”  
© 2002, 2003 E VERTETA PER SOT  
Të gjitha të drejtat të rezervuara